



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË**

---

<b>Numri i Ceshtjes :</b>	58339-00261-61-2020	<b>Data e Regjistrimit :</b>	28/01/2020
<b>Numri i Vendimit:</b>	61-2020-2619	<b>Data e Vendimit :</b>	22/07/2020

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË E PËRBËRË NGA:**

**GJYQTAR:** Hektor Sinanaj

**SEKRETARE:** Edita Mataj

Sot më datë 22/07/2020 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

**Të pandehurit:** xxxx

**Të pandehurit:** xxxx

**Të pandehurit:** . . , i biri i . dhe i . , i datëlindjes xxx

**Akuzuar:** Gjykimi i procedimit penal ne ngarkim te te pandehurit xxxxxxxxxxxxxx te akuzuar per kryerjen e vepres penale te "Pastrim i produkteve te vepres penale".

**VEREN :**

## V E N D I M

## “NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore

Hektor Sinanaj - Gjyqtar

Herila Cela - Gjyqtare

Elona Mihali - Gjyqtare

Ne seance gjyqsore publike, mori ne shqyrtim ceshtjen penale, qe i perket :

**KERKUESE: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor VI**

X

**KUNDER : TE PANDEHURVE( Per te cilet eshte pranuar “Kerkesa per rishikim**

e Kerkuese xxxxx) :

**xxxxx, lindur e banues neL.”Pavaresia” Vlore, mbrojtur nga Av.xxxx.****Txxxxxxx8**

nga Av. xxx

**Objekti:** Rigjykimin e te pandehurve xxx per kryerjen e vepres penale

“Pastrim i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale” parashikuar nga neni 287, geramat (a), (b) dhe (c) te K. Penal.

**Gjykata ne perfundim te gjykimit, degjoi konkluzionet perfundimtare “ Prokurorin i cili kerkoi :**

“Terheqjen e akuzes ne ngarkim te pandehurve xxxxxxxxxx dhe pushimin e ceshtjes penale, pasi f parashikohet nga ligji si veper penale.

Kthimin e dokumentacionit te sekuestruar gjate hetimeve paraprake ne lidhje me kete ceshtje penale.

Heqjen masen e sigurimit pasuror “sekuestro preventive” te caktuar me vendimin me nr. xxxx te Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Vlorë, e llojit “Kullotë”, “Pyll”, me sipërfaqe totale prej 54.6 hektarë, e ndodhur ne fshatin xxxxx, regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me numrat hipotekor xxxxx, që kanë pasur si titull pronësie vendimet me nr. xxxxxxx dhe vendimin me nr. xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.”

Degjoi mbrojtjesin e te pandehurve, qe kerkoi :

“Rishikimin e vendimit penal Nr. xxxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe vendimit nr. xxxxxx te Gjykates se Apelit

Vore ne kete menyre:

Deklarimin e pafajshem te te pandehurit xxxxx, akuzuar per kryerjen e vepres penale”*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal, pasi fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston.Deklarimin e pafajshem te te pandehurit xxxxxxxxxx, akuzuar per kryerjen e vepres penale”*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal, pasi fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston.

Kthimin e dokumentacionit të sekuestruar si provë materiale me procesverbalet e datës xxxxx pranë ASHK, Drejtoria

Vendore Vlore (ish- Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë).

Heqjen masen e sigurimit pasuror “sekuestro preventive” me vendimin me nr. xxxxxxxx të Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Vlorë, mbi pasurite e llojit “Kullotë”, “Pyll”, me sipërfaqe totale prej 54.6 hektarë, e ndodhur ne fshatin xxxxxxxxxx, regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me numrat hipotekor xxxxxx, që kanë pasur si titull pronësie vendimet me nr. xxxxxxxxxx dhe nr.175 datë 21.06.2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarkut Vlorë dhe vendimin me nr. xxxxxxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, dhe kthimin e tyre pronareve te ligjshem.” **Pasi administroi te gjitha aktet e provat shkesore te procedimit penal Nr.302 te vitit 2016, kostaton te drejte kerkese e organit te akuzes, jo vetem si e drejte procedurale, por edhe ne bindjen e kesaj gjykate, pas c’muarjes se provave.**

Rezultoi se fillimisht organi i akuzes, i ka akuzuar ne procedimin i mesiperem penal, i cili ka filluar mbi bazen e kallezimit penal te

cila mbi bazen e rekomandimeve te Njesise Task-Forcë per Verifikimin e Ligjshmerise dhe Menyres se Tjetersimit te Pronave te Paluajtshme Shteterore prane Kryeministrise, te percjella me shkesen nr. xxxxx ka kallezuar se vendimet nrxxxxx te dates 29.05.2006 dhe si me nr. xxxxx te KVKKP Vlore si dhe vendimi nr. xxxxxxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, jane me permbajtje te falsifikuar.

Gjykata e Shkalles se Pare Vlore me vendimin Nr. xxxxxxxxxx dhe Gjykata e Apelit Vlore me vendimin Nrxxxxxxx kane konkluduar se dokumentacioni mbi bazen e te cilave jane marre Vendimet nr. xxxxxxxxxx si dhe Vendimi nr.xxxxxxxx i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore (qe perbejne titullin e pronesise se trashegimtareve te shtetasve xxxxxxxx), ka rezultuar se keto vendime jane marre mbi bazen e dokumenteve te falsifikuara te perdorura nga shtetasi xxxxxxxx (trashegimtari) gjate vertetimit te faktit juridik te pronesise.

Gjykata me vendimin Nr. xxxxxxxx ka arsyetuar se per leshimin e ketyre titujve te pronesise, pra marrjen e vendimeve te K.V.K.K.P Vlore dhe Gjykates, eshte perdorur si dokument ligjor Vendimi xxxxxxxxxx i Keshillit Bashkiak Himare, me te cilin “vertetohet pronesia e shtetasit xxxxxxxx mbi siperfaqen totale 54.6 Ha “pyll e kullote” ne xx”, si dhe Vendimi nr. x, i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore qe eshte rrjedhim i ketij dokumentit.

Me vendimin Nr. x Gjykates se Shkalles se Pare Vlore (lene ne fuqi per kete pjese me vendimin Nr. x te Gjykates se Apelit Vlore), te cilat kane denuar te pandehurit x, falsiteti i “Vendimit nr. x. te x”, mbi te cilin jane bazuar Vendimet e K.V.K.K.P. Vlore dhe Gjykates se Shkalles se Pare Vlore (te cilet perbejne edhe titujt e pronesise), eshte vertetuar me Vendim te formes se prere nr. x te Gjykates se Apelit Vlore, sipas te cilit jane deklaruar fajtor shtetasit x, leshuesit e dokumentit, per vepren penale te “Falsifikimit te dokumenteve ne bashkepunim”, parashikuar nga nenet 186/3 e 25 te Kodit Penal.

Gjykata e kane bazuar vendimin e tyre nder te tjera ne vendimin Nr. x te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore e cila ka vendosur:

- Deklarimin e pafajshem te te pandehurit x, i akuzuar se ka kryer vepren penale “Falsifikimi i dokumentave” nga punonjesi që ka detyre te leshoje dokumentin, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 186/2 dhe 25 i K. Penal per shkak se fakti nuk perben veper penale dhe nuk provohet se e ka kryer vepren penale per te cilen akuzohet.

- Deklarimin e pafajshem te te pandehurit x i akuzuar se ka kryer vepren penale “Falsifikimi i dokumentave” nga punonjesi që ka detyre te leshoje dokumentin, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 186/2 dhe 25 i K. Penal per shkak se fakti nuk perben veper penale dhe nuk provohet se e ka kryer vepren penale per te cilen akuzohet.

Mbi ankimin e perfaqesuesit te organit te akuzes, Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin Nr. x ka vendosur : Ndryshimin e vendimit Nr. x te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, ne kete menyre:

- Deklarimin fajtor te te pandehurit x per vepren penale "Falsifikimi i dokumentave" nga punonjesi qe ka per detyre te leshoje dokumentin, ne bashkepunim dhe ne baze te nenit 186/2 dhe 25 te K. Penal denimin e tij me 1 vit burgim.
- Deklarimin fajtor te te pandehurit x, per vepren penale "Falsifikimi i dokumentave" nga punonjesi qe ka per detyre te leshoje dokumentin, ne bashkepunim dhe ne baze te nenit 186/2 dhe 25 te K. Penal denimin e tij me 1 vit burgim.
- Vuajtja e denimit te kryhet ne nje burg te sigurise se ulet dhe fillon nga data e ekzekutimit te vendimit.  
Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ne dhome keshillimi me vendimin x ka vendosur :
- Mospranimin e rekursit te paraqitur nga te gjykuarit x, kunder vendimit x te Gjykates se Apelit Vlore.

Sipas vendimit Nr. x Gjykates se Shkalles se Pare Vlore (lene ne fuqi per kete pjese me vendimin Nr. x te Gjykates se Apelit Vlore), te cilat kane denuar te pandehurit x, duke qene i falsifikuar "Vendimi nr. x Keshillit Bashkiak Himare", per rrjedhoje te peste Vendimet nr.x, te K.V.K.K.P. Vlore, si dhe Vendimi nr. x, i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore, jane me permbajtje te falsifikuar, pasi derivojne nga nje dokument i falsifikuar. Keshtu qe edhe regjistrimi i pasurise se paluajtshme prane Z.V.R.P.P. Vlore, si dhe transkriptimi - iskriptimi me tej i kesaj pasurie qe rrjedh nga keta tituj pronesie te falsifikuar ne permbajtje eshte gjithashtu i falsifikuar. Sipas tyre, duke qene se titulli i pronesise te te pandehurve ka qene i falsifikuar dhe duke qene se te pandehurit kane qene ne dijeni te falsitetit te vendimit nr. x te Keshillit Bashkiak Himare atehere me veprimet e tjetersimit te kryera mbi keto pasuri ne peridhen x kane konsumuar elementet e vepres penale te "Pastrim i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", parashikuar nga neni 287, geramat (a), (b) dhe (c) te K. Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore me vendimin Nr. x ka deklaruar fajtor te pandehurit xxx, per kryerjen e vepres penale "Pastrim i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", parashikuar nga neni 287, geramat (a), (b) dhe (c) te K. Penal. Vendimi i mesiperme eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Vlore me vendimin x per te pandehurit xx.

Mbi bazen e nje kerkese te mbrojtjes te zgjedhur te te denuarit x per kopje te vendimeve te Kes Himare, ne emer te subjektit x prej vitit 1992, Drejtoria e Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes, prane Bashkise Himare, me shkresen Nrxx Prot, date xxx ka informuar se ne dokumentat e administruara prane Drejtorise se Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes, prane Bashkise Himare, rezultonte edhe vendimi x i Keshillit Bashkiak Himare, per te cilen eshte deklaruar fajtor dhe eshte denuar x.

Ne keto kushte, i x eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore me kerkesen me objekt: "Rishikimin e ve Nr. x, te Gjykates se Apelit Vlore, per deklarimin fajtor dhe denimin e te pandehurve x, per shkak se prova e zbuluar rishtazi, se bashku me provat e vleresuara me vendimin x, te Gjykates se Apelit Vlore, tregojne se ky vendim eshte i gabuar.

Me vendimin nr. x Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore ka vendosur:

- Pranimin e kerkeses se paraqitur nga ana e te denuarit x, me objekt: Rishikimin e vendimit penal Nr. x, te Gjykates se Apelit Vlore, Baze Ligjore: nenet 449 e vijues te K. Pr. Penale.
- Dergimin e ceshtjes per rigjykim prane Gjykates se Apelit Vlore, me tjetër trup gjykues.  
Gjykata e Apelit Vlore me vendimin nr. x ka vendosur:
- Rishikimin e vendimit nr. x te Gjykates se Apelit, si vijon:
- Lenien ne fuqi te vendimit gjyqesor nr. xxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

Gjykata e Apelit Vlore ne vendimin e saj ka arsyetuar nder te tjera se: "Ne rastin konkret, rezulton e provuar se permbajtja e v date 31.01.2003 i Keshillit te Bashkise Himare dhe aktet e paraqitura ne gjykimin civil te perfunduar me vendimin nr.x, të Gjykates së Rrethit Gjyqësor se kerkuesi Petro Beja eshte pajisur me vertetimin e kryeplesqesise se fshatit x, (vertetimi x), vertetimin e komisionit te verifikimit te pronesise te fshatit x (procesverbali date 10.12.2002) dhe vertetimin e komisionit te verifikimit te pronesise prane Bashkise Himare. Pra, në mbledhjen e keshillit bashkiak Himare, është paraqitur dhe administruar i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në pikën 7 te VKM Nr. 560, date

16.10.1995. Këto prova janë analizuar dhe shqyrtuar në gjykim dhe në përfundim, me x të Keshillit Bashkiak Himare, është vendosur qe shtetasit x, si trashëgimtar i x, ti njihet e drejta e pronësise mbi 54.6 ha tokë kullotë dhe pyll.

Në analize të këtyre rrethanave, ashtu sikurse ka rezultuar e provuar gjate gjykimit ne Shkalle te Pare, dokumenti vendim x, i Keshillit Bashkiak Himare, nuk eshte i falsifikuar, pasi eshte leshuar konform VKM nr. 560, datë 16.10.1995 "Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 "Për kompensimin ne vlere te ish-pronareve te tokes bujqesore"

Gjykata e Apelit Vlore vlereson se ka prova te mjaftueshme, te cilat te cojne ne perfundimin e padiskutueshem, jashte cdo dyshimi te arsyeshem, qe provojne se dokumenti nr. xxx, i Keshillit Bashkiak Himare, nuk eshte i falsifikuar, prandaj bazuar ne nenin 328/1/a dhe 388/a te K. Pr. Penale duke qene se fakti nuk ekziston ka lene ne fuqi vendimin nr. xxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

Ne permbledhje sa me siper bazuar ne nenin 328/1/a dhe 388/a te K. Pr. Penale rezulton qarte se fakti nuk ekziston prandaj vendimi Nr. 528, date

13.12.2011 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte i drejte dhe si i tille duhet te lihet ne fuqi"

#### **Gjykata gjene te arsyetuar drejte mbrojtjen e te pandehurve se :**

"Nga terësia e akteve te administruara gjate gjykimit ne shkalle te pare ne harmoni edhe me provat e paraqitur rishtazi, Vendimi nrxxx i Gjykates se Apelit Vlore, sipas të cilit vendimi Nr.x i Keshillit te Bashkisë Himare, nuk eshte i falsifikuar dhe per pasoje fakti penal nuk ekziston si dhe shkresa Nr. xxx sipas te ciles ne dokumentat e administruara prane Drejtorise se Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes, prane Bashkise Himare, rezultonte edhe vendimi Nrxxxx i Keshillit Bashkiak Himare, provon qarte pafajesine e te pandehurve xxx, per kryerjen e vepres penale "Pastrim i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", parashikuar nga neni 287, geramat (a), (b) dhe (c) te K. Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore me vendimin Nr. xxx ka vendosur të pranojë kërkesën për rishikimin e vendimit penal Nr. xxxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe vendimit nr. xxxx te Gjykates se Apelit Vlore, per deklarimin fajtor dhe denimin e te pandehurve xxx, për shkak se faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë, si dhe pas vendimit janë zbuluar prova të reja të cilat të vleresuara së bashku tregojnë se vendimi është i gabuar.

Nga arsyetimi vendimit penal xxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore (lënë në fuqi me ndryshime me vendimin nrxxxx gjykates se Apelit Vlore), rezulton që këto vendime mbështeten mbi vendimin penal Nr. x, te Gjykates se Apelit Vlorë, vendim i cili ka dënuar të gjykuarit xxx, për falsifikimin e dokumentit vendimit xxxx i Keshillit te Bashkisë Himarë, dokument i cili është vlerësuar si i fallsifikuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, pasi pavarësisht se ishte i nënshkruar nga të akuzuarit, dhe i vulosur me vulën e Bashkisë Himarë, nuk ndodhej në Bashkinë Himarë, për pasojë nuk kishte dalë nga ai institucion.

Pas shpalljes së vendimit penal x, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe vendimit nr. x, date

Gjykates se Apelit Vlore ka rezultuar se faktet e vëna në themel të këtij vendimi, fallsiteti i vendimit x të Keshillit te Bashkisë Himarë, deklaruar me vendimin x, te Gjykates se Apelit Vlorë, nuk pajtohen me një vendim tjetër të formës së prerë, konkretisht me ato të vendimit nr. x të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kjo pasi në vendimin e dytë, atë me nr. nr.x, Gjykata e Apelit pasi ka marrë në shqyrtim me shkresen Nr.x ka informuar se ne dokumentat e administruara prane Drejtorise se Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes, prane Bashkise Himare, rezultonte edhe vendimi Nr. x i Keshillit Bashkiak Himare, per te cilen eshte deklaruar fajtor dhe eshte denuar x, ka vendosur të rishikojë vendimin nr. x te Gjykates se Apelit, duke lënë në fuqi vendimin gjyqesor nr. x, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

Gjithashtu sipas shkresës Nr.x Prot, date 17.06.2019 në nga e cila rezulton se ne dokumentat e administruara prane Drejtorise se Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes, prane Bashkise Himare, rezultonte edhe vendimi Nr. x i Keshillit Bashkiak Himare, bazuar në nenin 450/c të K.Pr.Penale, rezulton se kjo provë, vlerësuar së bashku me provat e tjera të marra në shqyrtim, provojnë se Vendimet nr. x, te K.V.K.K.P. Vlore, si dhe Vendimi nr. x, i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore, nuk janë mbështetur në prova të fallsifikuara, pasi "Vendimi nr. x te Keshillit Bashkiak Himare", ndryshe nga sa është paraqitur nga prokuroria në gjykimin e mëparëshëm, është gjetur në Bashkinë Himarë, dhe si i tillë është vërtetuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë që nuk ka qënë i falsifikuar.

Neni 287 i K. Penal Parashikon se:

"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;
- d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; - dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim .

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

- a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;
- b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashikuar ose amnistuar;
- c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;
- ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;
- d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Në ndryshim nga veprat e tjera penale, pastrimi i produkteve të veprës penale, edhe pse i parashikuar në mënyrë të pavarur nga K. Penale, është në mënyrë të paevitueshme dhe të pazgjydhshme i lidhur me vet veprën penale, e cila i ka prodhuar ose gjeneruar produktet e veprës penale. Vetë terminologjia e ndërtimit të veprës e cileson një gjë të tillë. Të gjitha legjislacionet të cilat e përfshijnë këtë vepër penale në kode ose ligje të veçanta të miratuara, parashikojnë elementin e produktit si pjesë kryesore e gjeneruar nga veprimtaria e paligjshme.

Ne rastin konkret rezulton se nuk kemi veprë penale që ka sjelle produkt pasi me vendimin nr. x të Gjykatës së Apelit Vlore, e cila ka arsyetuar se fakti në ngarkim të pandehurve x nuk ekziston dhe për pasojë nuk mund të kemi produkt të ndonjë veprë penale.

Vepra penale e parashikuar nga neni 287 i K. Penal kryhet me dashje direkte, dashje e cila ka për qëllim fshehjen e origjinës së përfitimit të një pasurie të përfituar në mënyrë të jashtëligjshme nëpërmjet futjes së saj në treg, nëpërmjet transaksioneve të ndryshme tregtare, kalimeve të pronësisë apo këmbimit etj, të përcaktuara si elementë të anës objektive të veprës penale. Produkti i cili fshihet apo pastrohet duhet të jete i përfituar në mënyrë të jashtëligjshme dhe se dyti subjekti i veprës penale duhet të jetë në dijeni të përfitimit me anë të një veprë penale apo veprimtarie kriminale të pasurisë objekt i veprimtarisë tregtare.

Të pandehurit, nuk kanë përfituar në mënyrë të paligjshme pronat e pretenduara nga prokuroria. Këto prona kanë qënë objekt shqyrtimi i procedurës administrative të parashikuar në ligjin përkatës për njohjen, kthimin dhe kompesimin e pronave, kanë qënë objekt shqyrtimi i gjykatës civile, në disa procese civile, kanë qënë objekt hetimi dhe gjykimi penal, dhe në përfundim të këtyre procedurave të pandehurit provohet se të pandehurit nuk i kanë përfituar pronat si pasojë e një veprë penale apo veprimtarie kriminale.

Në lidhje me vendimin x të Këshillit Bashkiak Himarë i cili është pretenduar nga prokuroria se është i falsifikuar, theksojmë se me vendimin nr. x Gjykata e Apelit Vlore ka arsyetuar ndër të tjera se: “Ne rastin konkret, rezulton e provuar se përmbajtja e vendimit nr. x i Këshillit të Bashkisë Himare dhe aktet e paraqitura në gjykimin civil të perfunduar me vendimin nr. x, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor se kerkuesi xxxx është pajisur me vertetimin e kryepleqesise se fshatit x, (vertetimi date 10.12.2002), vertetimin e komisionit të verifikimit të pronësisë të fshatit xxxx (procesverbali date 10.12.2002) dhe vertetimin e komisionit të verifikimit të pronësisë pranë Bashkisë Himare.

Pra, në mbledhjen e keshillit bashkiak Himare, është paraqitur dhe administruar i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në pikën 7 të VKM Nr. 560, date

16.10.1995. Këto prova janë analizuar dhe shqyrtuar në gjykim dhe në përfundim, me vendimin Nr. x Keshillit Bashkiak Himare, është vendosur që shtetasit x, si trashëgimtar i xxx, ti njihet e drejta e pronësisë mbi 54.6 ha tokë kullotë dhe pyll.

Në analize të këtyre rrethanave, ashtu sikurse ka rezultuar e provuar gjatë gjykimin në Shkallë të Pare, dokumenti vendim nr. x, i Keshillit Bashkiak Himare, nuk është i falsifikuar, pasi është leshuar konform VKM nr. 560, datë 16.10.1995 “Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronareve të tokës bujqësore”

Gjykata e Apelit Vlore vlereson se ka prova të mjaftueshme, të cilat të çojnë në përfundimin e padiskutueshem, jashtë cdo dyshimi të arsyeshem, që provojnë se dokumenti nr. x i Keshillit Bashkiak Himare, nuk është i falsifikuar, prandaj bazuar në nenin 328/1/a dhe 388/a të K. Pr. Penale duke qene se fakti nuk ekziston ka lene në fuqi vendimin nr. x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlore.

Ne përmbledhje sa me siper bazuar në nenin 328/1/a dhe 388/a të K. Pr. Penale rezulton qarte se fakti nuk ekziston prandaj vendimi xxx i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlore është i drejte dhe si i tille duhet të lihet në fuqi”

Prokuroria në çështjen penale objekt gjykimi nuk ka vërtetuar se rrjedhojë e cilës veprimtari kriminale, apo cilës vepër penale është pasuria e përfituar nga shtetasit x etj. Së pari duhet të ishte vërtetuar origjina kriminale e kësaj pasurie, më tej dijenia e të pandehurve për këtë origjinë dhe qëllimi i tyre në kryerjen e veprimeve përkatëse tregtare për fshehjen e kësaj origjine. Është vërtetuar e kundërta, që me vendim gjyqësor të formës së prerë se vendimi xxxxxx të Këshillit Bashkiak Himarë dhe fakti në ngarkim të pandehurve xxxx nuk ekziston. Sipas VKM nr. 560 datë 16.10.1995 “Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699 datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronareve të tokës bujqësore”, pika 7 e tij, parashikon:

“Në rastet kur zyra e hipotekës ose ajo e kadastrës nuk disponon të dhëna për të lëshuar vërtetim zyrtar të pronësisë sipas regjistrave përpara reformës agrare (për ato zona ku është zbatuar kjo reformë), vërtetimi i pronësisë do të bëhet sipas kësaj procedure:

a) Kryepleqësia e fshatit, mbi bazën e kërkesës së të interesuarit, lëshon vërtetim zyrtar për sipërfaqen e ish-pronës, ish-pronarit e saj dhe emrat e ish-pronarëve kufizues.

b) Vërtetimi i kryepleqësisë së fshatit i kalon për verifikim e saktësim komisionit të verifikimit të pronësisë në komunën përkatëse i cili përbëhet nga: Sekretari i keshillit të komunës – kryetar; Agronomi i drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit të rrethit, që punon pranë asaj komune – anëtar; Topografi, që punon pranë asaj komune - anëtar.

c) Vendimi i keshillit të komunës që merret mbi bazën e vërtetimit të komisionit të verifikimit të pronësisë në komunë, i dërgohet zyrës së kadastrës ku, pasi të përpunohet nga specialistët e cituar në pikën 2 të këtij vendimi, i kalohet për të vendosur përgjegjësit të kadastrës. Përgjegjësi i kadastrës i lëshon sipas rastit vërtetim pozitiv ose negativ pretenduesit, të shoqëruar me një kopje të vendimit të keshillit të komunës.

Këto dokumente do të jenë të vlefshme si provë shkresore për vërtetimin e pronësisë, me vendim të gjykatës së rrethit përkatës.”

Sipas këtij akti nënligjor, vendimi i keshillit të komunes/bashkisë merrej mbi bazën e vërtetimit të kryepleqesise se fshatit dhe vertetimit të komisionit të verifikimit të pronësisë në fshat, të cilat kalonin për verifikim e saktësim të komisionit të verifikimit përkatës dhe me pas paraqiteshin për miratim pranë Keshillit Bashkiak.

Rezulton e provuar se përmbajtja e xxx dhe aktet e paraqitura në gjykimin civil të perfunduar me vendimin nr. xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor se kerkuesi xxx është pajisur me vertetimin e kryepleqesise se fshatit xxxx (vertetimi date

10.12.2002), vertetimin e komisionit të verifikimit të pronësisë të fshatit xxxi (Procesverbali date 10.12.2002) dhe vertetimin e komisionit të verifikimit të pronësisë pranë Bashkisë Himare.

Në mbledhjen e keshillit bashkiak himare është paraqitur dhe administruar i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në pikën 7 të VKM nr.560 datë 16.10.1995. Këto prova janë analizuar dhe shqyrtuar në gjykim dhe në përfundim, me vendimin xxxx të Keshillit Bashkiak Himare, është vendosur që shtetasit Petro Beja, si trashëgimtar i xxx ti njihet e drejta e pronësisë mbi 54.6 ha tokë kullotë dhe pyll. Në analize të këtyre rrethanave, ashtu sikurse ka rezultuar e provuar gjatë gjykimin të rishikimit të vendimit për xxx, dokumenti vendim Nr. xxxxx i Keshillit Bashkiak Himare, nuk është i falsifikuar pasi është leshuar konform VKM nr. 560 datë 16.10.1995 “Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699 datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronareve të tokës bujqësore”.

nr.7699 datë 21.4.1993 "Për kompensimin ne vlere te ish pronareve te tokes bujqesore".

Po ashtu rezulton se Bashkia Himare nuk ka ngritur pretendime ne lidhje me falsitetin e ketij dokumenti te perdorur ne gjykim kunder tij i cili ka perfunduar me vendimin nr. xxxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqesor, perkundrazi e ka njohur per te vertete. Gjithashtu Bashkia Himare nuk ka paraqitur ankim kunder ketij vendimi gjyqesor, pra ka njohur dhe pasojat e ketij akti. Sjellja e pales se paditur ne gjykim, provon faktin se ky dokument ka dale nga ato zyra, sic eshte pranuar nga vete leshuesit e tij ne gjykimin ndaj tyre, dhe me e pakta ne kete rast, nuk mund te di organi i akuzes nese kane qene ne dijeni te pandehurit per problemet qe kane shoqeruar kete akt ne lidhje me pasqyrimin e tij ne librin e protokollit apo mosmbajtjen e procesverbalit te mbledhjeve te ketij keshilli.

Të gjitha faktet e vëna në themel te vendimit Nr. xxxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore (lënë në fuqi me ndryshime me vendimin nr. xxxx te Gjykates se Apelit Vlore), mbështeten mbi vendimin penal Nr. xxx, te Gjykates se Apelit Vlorë, vendim i cili ka dënuar të gjykuarit xxxx, për falsifikimin e dokumentit vendimit xxx i Keshillit te Bashkisë Himarë, dokument i cili është vlerësuar si i fallsifikuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, pasi pavarësisht se ishte i nënshkruar nga të akuzuarit, dhe i vulosur me vulën e Bashkisë Himarë, nuk ndodhej në Bashkinë Himarë, për pasojë nuk kishte dalë nga ai institucion.

Pas shpalljes së vendimit penal Nr. xxxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe vendimit nr. xxx, date Gjykates se Apelit Vlore ka rezultuar se faktet e vëna në themel të këtij vendimi, fallsiteti i vendimit Nr. xxx të Keshillit te Bashkisë Himarë, deklaruar me vendimin Nrxxxx, te Gjykates se Apelit Vlorë, nuk pajtohen me një vendim tjetër të formës së prerë, konkretisht me ato të vendimit nrxxx të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kjo pasi në vendimin e dytë, atë me nr. nrxxxx9, Gjykata e Apelit pasi ka marrë në shqyrtim me shkresen Nr. xxx ka informuar se ne dokumentat e administruara prane Drejtorise se Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes, prane Bashkise Himare, rezultonte edhe vendimi xxx i Keshillit Bashkiak Himare, per te cilen eshte deklaruar fajtor dhe eshte denuar xxx, ka vendosur të rishikojë vendimin nr. xxxx te Gjykates se Apelit, duke lënë në fuqi vendimin gjyqesor nrxxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

Gjithashtu vendimet faktet e vena ne themel te vendimit penal Nr. xxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe vendimit nr. xxx te Gjykates se Apelit Vlore, pare në dritën e provës së re shkresës Nr. xx në nga e cila rezulton se ne dokumentat e administruara prane Drejtorise se Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes, prane Bashkise Himare, rezultonte edhe vendimi Nr. xxxx i Keshillit Bashkiak Himare, bazuar në nenin 450/c të K.Pr.Penale, rezulton se kjo provë, vlerësuar së bashku me provat e tjera të marra në shqyrtim, provojnë se Vendimet nrxxxx, date xxxx, te K.V.K.K.P. Vlore, si dhe Vendimi nr.

xxxx, i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore, nuk janë mbështetur në prova të fallsifikuara, pasi "Vendimi xxxx te Keshillit Bashkiak Himare", ndryshe nga sa është paraqitur nga prokuroria në gjykimin e mëparëshëm, është gjetur në Bashkinë Himarë, dhe si i tillë është vërtetuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë që nuk ka qënë i fallsifikuar.

Si perfundim duke qene se nga vete organi i akuzes deklarohet se pas dhe ketij rigjykimi "fakti penal nuk egziston", gjykata bazuar ne nenin 275 dhe

389 te K. Pr. Penale duhet te shprehet edhe ne lidhje me heqjen e mases se sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive" te caktuar me vendimin me xxxx të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Vlorë, per pasurite e paluajtshme te llojit "Kullotë", "Pyll", me sipërfaqe totale prej 54.6 hektarë, e ndodhur ne fshatin Gjilekë-Dhërmë, regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me numrat hipotekor xxxxxx që kanë pasur si titull pronësie vendimet me nr. xxx të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarkut Vlorë dhe vendimin me nr. xxxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

**Neni 275** i K. Pr. Penale parashikon se:

*sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuar për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale.*

Neni 389 parashikon se:

*"Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklarohet heqjen e masave të tjera të sigurimit. Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit. Dokumentacioni i sekuestruar i cili nuk është provuar të jetë i fallsifikuar, duhet t'u kthehet institucioneve përkatëse, me qëllim administrimin e tyre sipas qëllimit të tyre.*

**Sipas nenit Neni 377 te K.Pr.Penale :**

**Kalimi i akteve prokurorit**

*(Hequr fjalia e dytë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

*"1. Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes."*

**Neni 387**

**Vendimi i pushimit të çështjes**

*(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

*1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat "c", "ç", "e" dhe "ë", të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkaku.*

**Ne interpretim te dispozitave penale te mesiperme, gjykata c'mon te miratoje kerkesen e Prokurorit.**

**PER KETO ARESYE :**

**Gjykata pasi pa dhe nenet 377, 387 te K.Pr.P.**

**VENDOSI :**

1. **Pranimin e kerkeses.**

2. **Kalimin e akteve te procedimit penal nr.xxx Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore, procedim penal ne ngarkim te pandehurve xxx dhe pushimin e ceshtjes penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.**

1. **Kthimin e dokumentacionit te sekuestruar gjate hetimeve paraprake ne lidhje me kete ceshtje penale.**

4. **Heqjen masën e sigurimit pasuror "sekuestro preventive" te caktuar me vendimin me nr. xxxx të Gjykatës se Rrethi Gjyqësor Vlorë, e llojit "Kullotë", "Pyll", me sipërfaqe totale prej 54.6 hektarë, e ndodhur ne fshatin xxxxx kanë pasur si titull pronësie vendimet me nr. xxxx dhe nr.xxxx të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarkut Vlorë dhe vendimin me nr. xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë." Shpenzimet gjyqsore organit te akuzes.**

**Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 10 diteve.**

**U shpall ne Vlore dt.22.07.2020**

**GJYQTARE GJYQTARE  
ELONA MIHALI HERILA CELA**

**HEKTOR SINANAJ**

**GJYQTARI**

**Për këto arsye**

**VENDOSI:**

**SHPENZIMET GJYQESORE**

<b>Kërkesëpadia</b>	0
<b>Taksa Gjyqësore</b>	0
<b>Noterizime</b>	0
<b>Njoftime</b>	0
<b>Akt ekspertimi</b>	0
<b>Avokat</b>	0
<b>Gjithsej</b>	0

**GJYQTAR:**

**Hektor Sinanaj**